



VENDIM

Nr. 4, Datë 19.01.2017

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT NË
TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Kapitulli III, pika III.1.2 të “Rregullave të përkohshme të tregut Shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 139, datë 25.08.2016, dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Draft Rregullores për Procedurën e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoritë teknike,

Konstatoi se :

- Kjo Rregullore hartohet në zbatim të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara me vendim të Bordit të ERE nr. 139, datë 25.08.2016, Kapitulli III, pika III.1.2
- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Rregullores për procedurën e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Draft Rregullores për Procedurën e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë

OST sh.a., KESH sh.a, OSHEE sh.a, MEI, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI